



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH.nr. 276/19**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje z. Goran Milenković– Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Studio Hapsira”–Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Hartimi projekteve zbatuese për rrugë trotuare dhe ura” me nr. i prokurimit 634-18-7116-2-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Klinës, më datë: 03.07.2019, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Studio Hapsira”–Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi projekteve zbatuese për rrugë trotuare dhe ura” me nr. i prokurimit 634-18-7116-2-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Klinës.

**II. ANULOHET**, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Hartimi projekteve zbatuese për rrugë trotuare dhe ura” me nr. i prokurimit 634-18-7116-2-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Klinës, dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim**.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Studio Hapsira”–Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Data e njoftimi për kontratë është bërë me dt: 27.09.2018.

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 08.10.2018.

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave është bërë me dt: 15.02.2019.

Njoftimi i vendimit për anulim të aktivitetit të prokurimit është bërë me dt: 17.05.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 21.05.2019.

Me dt: 23.05.2019, Autoriteti kontraktues Komuna e Klinës, ka marr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik: “Studio Hapsira”–Prishtinë, si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues: “Studio Hapsira”–Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 03.06.2019, me nr.276/19, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Hartimi projekteve zbatuese për rrugë trotuare dhe ura” me nr. i prokurimit: 634-18-7116-2-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Klinës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 9, 10, 24, 27, 28, 40, 51, 59, 60, 56, 64, 67, dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 06.06.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues, në raportin e dt: 17.06.2019, sqaron se ku aktiviteti i prokurimi katër herë radhazi është vlerësuar nga ana e AK-së, si rezultat i ankesave të parashtruara nga ana e OE pjesëmarrës në tender.

Autoriteti Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim ka nxjerr vendim në përputhje me nenin 108/A, dhe e refuzon ankese me arsyetimin e se: “A.K.- komuna e Klinës ka ANULUAR këtë procedure



te Prokurimit e cila nga pamundësia e përfundimit te procedurës ne afatin me optimal te nevojshëm te filluar ne Vitin 2018 , dhe nga Ankesat e te vetmeve O.E', ( dy nga ta ) ne Ankesat e tyre te adresuara ne OSHP , dhe Vendimeve te OSHP , ka ardhë deri te Humbja e Nevojave për këtë , si dhe HYMBJA E MJETEVE TE BUXHETUARA ne vitin 2018.

I pa kënaqur me përgjigjen lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim, OE "Studio Hapsira" parashtron ankesë në OSHP për shkelje të dispozitave të LPP-së të lartë cekura në ankesë.

OE "Studi Hapsira " si palë e pakënaqur parashtron ankesë në OSHP, dhe pretendimet ankimore janë identike me pretendimet që janë ngritë përmes kërkesës për rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues, dhe njëkohësisht kemi t ë bëjmë me një ankesë ku pala është e njëjtë, aktiviteti i prokurimit është i njëjtë dhe pretendimet ankimore janë të njëjta.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe për këto pretendim ankimor Paneli Shqyrtues me datë 12.12.2018 ka lëshuar njoftimin me nr. 660/18, dhe gjithashtu me datë 08.02.2019, ka nxjerr vendimin me nr.PSH.11, dhe 17/19, ku rekomandon që aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim dh gjithashtu e me date 07.05.2019 lëshon vendim nr PSH. 99/19 ku kërkon rivlerësim

Pas vendimit të PSH për rivlerësim , AK e anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se nuk ka mjete financiare për këtë aktivitet .

Arsyet e anulimit janë te pabazuara për faktin se;

- Kemi te bëjmë me kontrate kornize.
- Shërbimet e projektimi janë të domosdoshme për komunën
- Dhe për anulimin e këtij aktiviteti te prokurimit nuk janë plotësuar kërkesat e nenit 62 të LPP-së.

Shkeljet e konstatuara të LPP-së .

AK gjatë zbatimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka respektua nenet si ne vijim:

- Nenin 9 te LPP-së
- Nenin 62 të LPP-së pasi për anulimin e aktivitetit të prokurimit nuk janë plotësuar dispozitat e këtij neni.
- Nenin 105 të LPP-së

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i rekomandon Panelit Shqyrtues që ankesën e OE “Studio Hapsira”, është të pranoj të bazuar dhe njëkohësisht i rekomandon Autoritetit Kontraktues që të rivlerësoj aktivitetin e prokurimit.

Operatori ekonomik “Studio Hapsira”–Prishtinë, përmes parashtresës me shkrim të datës: 18.07.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues Komuna Klinë, përmes parashtresës me shkrim të datës: 19.07.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 03.07.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i AK-së, mungon në seance, eksperti shqyrtues i OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për anulim, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Halimi deklaroj: Ne pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues, për arsye se Autoriteti Kontraktues KK-Kline, ka vepruar në kundërshtim me LPP-në dhe ligjin mbi financat, faktikisht pa i siguruar fondet publike duke na shkaktuar shpenzimet financiare ku 4 here kemi paguar sigurim të vazhdimin të validitetit edhe e njëjta na ka shpallur fitues dy (2), here ku ka edhe një vendim të OSHP-së, dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e përshtatshmërisë profesionale dhe teknike në DT. Ne nuk pajtohemi me vendimin e OSHP-së. 212/19 të datës 11.06.2019, për arsye se OE ankues “PROing” SH.P.K. panelin shqyrtues e ka qitur në lajthitje duke prezantuar inxhinier të konstruksionit në kuadër të makinerisë me këtë rast ka shfrytëzuar vakuumin e mos përpilimin e specifikave teknike nuk kanë qenë të precizuara mirë në DT dhe me natyrën e punës së kontratës, na është sugjeruar neve në vendim që të shkojmë në fakultetin e makinerisë dhe ta verifikojmë këtë diplomë, ne kemi shkuar në fakultet kemi bërë hulumtimin e diplomës edhe programit mësimorë dhe kemi konstatuar që kjo diplomë ky kriter që pretendon OE “PRO ing” është inxhinier i konstruksioneve prodhuese nuk përputhet me natyrën e punës së këtij AP, ky kriteri i shpikur nuk është i precizuar në DT andaj është e papranueshme nga ne si kompani që të përdoret një kriter i paspecifikuar dhe i përfshirë në DT.



Ne konsiderojmë që si kompani kemi dorëzuar dosjen e tenderit konform kritereve profesionale dhe teknike të përfshira në DT dhe njoftimin për kontratë. Dhe konsiderojmë që jemi të përgjegjshëm.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertit shqyrtues z. Sheqiri deklaroj: Qëndroj prapa raportit të dhënë në ekspertizë.

Ne fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së, Halimi deklaroj: Kërkojmë që ankesa jone të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjeve të provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se aktiviteti i prokurimit në fjalë katër herë radhazi është vlerësuar nga ana e AK-së, si rezultat i ankesave të parashtruara nga ana e OE-ve, pjesëmarrës në tender.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues, lidhur me kërkesën për rishqyrtim ka nxjerr vendim në përputhje me nenin 108/A, dhe e refuzon ankesë e OE ankues me arsyetimin e si në vijim : AK.- Komuna e Klinës ka ANULUAR këtë procedure të Prokurimit e cila nga pamundësia e përfundimit të procedurës në afatin me optimal të nevojshëm të filluar në Vitin 2018 , dhe nga Ankesat e të vetmeve OE, ( dy nga ta ) në Ankesat e tyre të adresuara në OSHP , dhe Vendimeve të OSHP , ka ardhë deri të Humbja e Nevojave për këtë , si dhe HYMBJA E MJETEVE TË BUXHETUARA në vitin 2018.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE “Studio Hapsira ” si palë e pakënaqur parashtron ankesë në OSHP, dhe pretendimet ankimore janë identike me pretendimet që janë ngritë përmes kërkesës për rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues, dhe njëkohësisht kemi të bëjmë me një ankesë ku pala është e njëjtë, aktiviteti i prokurimit është i njëjtë dhe pretendimet ankimore janë të njëjta.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe për këto pretendim ankimor Paneli Shqyrtues me datë 12.12.2018, ka lëshuar njoftimin me nr. 660/18, dhe gjithashtu me datë 08.02.2019, ka nxjerr vendimin me nr.PSH.11 dhe 17/19, ku rekomandon që aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim dhe gjithashtu e me datë: 07.05.2019, lëshon vendim nr.PSH 99/19, ku kërkon rivlerësim

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas vendimit të PSH 99/19, për rivlerësim autoriteti kontraktues Komuna e Klinës, e anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se nuk ka mjete financiare për këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se arsyet e anulimit janë të pabazuara për faktin se: Kemi të bëjmë me kontrate kornize, Shërbimet e projektimi janë të domosdoshme për Komunën, dhe për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit nuk janë plotësuar kërkesat e nenit 62 të LPP-së. Andaj autoriteti kontraktues Komuna e Klinës, gjatë zbatimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektua nenet si ne vijim: Nenin 9, 62 dhe nenin 105, të LPP-së.

Paneli shqyrtues duke u nisur nga të dhënat si me lart vjen në përfundim se anulimi i aktivitetit të prokurimit në fjalë është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së. Prandaj, obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave ligjore të zbatueshme për këtë aktivitetet të prokurimit dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK - Komuna e Klinës

1x1 OE - "Studio Hapsira"-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković

